UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program	Marketing dhe menaxhment i inovacionit (2026/2027)
Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	240
Kodi	MIM-240-26-27
Titulli	Ekonomist i diplomuar - Drejtimi: Marketing dhe menaxhment i inovacionit
Data akreditimit	30.01.2026

Përshkrimi i programit

Programi studiore i ciklit të parë në Marketing dhe menaxhment i inovacionit është i dizajnuar për t'u ofruar studentëve njohuri të gjera mbi parimet moderne të marketingut dhe rolin e inovacionit në zhvillimin e bizneseve. Programi kombinon njohuritë teorike me aplikimin praktik për të përgatitur studentët për tregun dinamik dhe konkurrues të punës. Studentët studiojnë fusha kryesore si sjellja e konsumatorit, hulumtimi i tregut, marketingu digjital, marketingu strategjik, branding-u dhe komunikimi. Paralelisht, programi fokusohet në menaxhimin e inovacionit, përfshirë gjenerimin e ideve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, sipërmarrjen dhe implementimin e zgjidhjeve inovative në organizata. Gjatë studimeve, studentët zhvillojnë aftësi analitike, kreative dhe menaxheriale që u mundësojnë të identifikojnë mundësi tregu, të dizajnojnë strategji efektive marketingu dhe të mbështesin rritjen e bazuar në inovacion. Të diplomuarit përgatiten për karriera në departamente marketingu, konsulencë, sipërmarrje dhe fusha të tjera të lidhura me zhvillimin e biznesit dhe inovacionin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Karriera

Të diplomuarit e këtij programi studimor përgatiten për mundësi të ndryshme karriere si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Ata mund të punojnë në departamente marketingu, agjenci të reklamimit dhe marketingut digjital, menaxhim të brendeve, kompani për hulumtim të tregut dhe kompani konsulence. Rrugët e zakonshme të karrierës përfshijnë pozita si specialist i marketingut, menaxher i marketingut digjital, menaxher i brendit, analist i hulumtimit të tregut, menaxher i produkteve dhe menaxher i zhvillimit të biznesit. Të diplomuarit gjithashtu mund të ndjekin karrierë në menaxhimin e inovacionit dhe projekteve, duke ndihmuar organizatat në zhvillimin dhe implementimin e produkteve, shërbimeve dhe strategjive të reja biznesore. Për më tepër, programi i përgatit studentët për sipërmarrje, duke u mundësuar të hapin dhe menaxhojnë bizneset e tyre duke aplikuar qasje inovative dhe të orientuara drejt tregut. Të diplomuarit janë të aftë të punojnë në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Të diplomuarit posedojnë një spektër të gjerë njohurish teorike dhe praktike në fushën e menaxhmentit, inovacionit dhe marketingut. Ata i kuptojnë konceptet bazë ekonomike, juridike dhe organizative që lidhen me funksionimin e biznesit dhe

sektorit publik, duke përfshirë: të drejtën afariste dhe tregtare, mikro- dhe makroekonominë, financat korporative, kontabilitetin dhe sistemet informative të biznesit. Gjithashtu, ata kanë vetëdije për zhvillimin historik dhe bashkëkohor të teorive të menaxhmentit dhe për trendet në marketingun digjital dhe strategjitë inovative.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Studentët janë të aftë të zbatojnë në mënyrë kritike, kreative dhe të pavarur njohuritë e fituara në situata të reja dhe të panjohura, veçanërisht në kontekste multidisiplinare dhe biznesore. Ata tregojnë aftësi për planifikimin, udhëheqjen dhe vlerësimin e kërkimeve të pavarura, duke përdorur mjete bashkëkohore kompjuterike dhe analitike. Ata demonstrojnë kreativitet në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe aftësi për përdorimin e teknologjive informatike në procesin e marrjes së vendimeve. Gjithashtu, posedojnë frymë sipërmarrëse dhe njohuri për fillimin dhe zhvillimin e biznesit të tyre.

Aftësitë për të vlerësuar

Aftësi për integrimin dhe sintetizimin e njohurive nga disa disiplina të ndërlidhura, si menaxhmenti, informatika dhe ekonomia e biznesit. Studentët janë të aftë të marrin vendime në situata komplekse dhe të paparashikueshme biznesi, madje edhe në kushte të informacionit të paplotë. Ata tregojnë vetëdije për pasojat etike, ligjore dhe shoqërore të vendimeve të tyre. Gjithashtu posedojnë aftësi për analizën e konkurrencës, identifikimin e faktorëve kyç të tregut dhe marrjen e vlerësimeve të qëndrueshme në nivel operativ të menaxhimit

Aftësitë e komunikimit

Studentët mund të prezantojnë në mënyrë të qartë, të paqartë dhe profesionale analizat, përfundimet dhe propozimet e tyre të biznesit, duke përshtatur stilin e shprehjes sipas audiencës (profesionale ose më të gjerë). Ata tregojnë aftësi për të iniciuar dhe udhëhequr diskutime, përgatitjen e raporteve dhe prezantimeve. Kanë përvojë në komunikim brenda ekipeve multikulturore dhe ndërdisiplinare, si dhe në paraqitjen e ideve të biznesit para palëve të interesuara (stakeholders).

Aftësitë e të mësuarit

Studentët tregojnë aftësi për identifikimin e nevojave të tyre për mësim dhe për planifikimin dhe realizimin e arsimit shtesë individual dhe në ekip. Ata përdorin në mënyrë të pavarur literaturë shkencore dhe profesionale, kryejnë analiza biznesi dhe tregu, dhe janë të aftë të përmirësojnë njohuritë e tyre përmes mjeteve moderne të TIK-ut. Ata janë të aftë për të mësuar gjatë gjithë jetës në kontekstin e ekonomisë së rrjetëzuar dhe fushave të biznesit që ndryshojnë shpejt.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [C2638] [6.0 SETK] **Bazat e ekonomisë dhe biznesit**
- [C2639] [6.0 SETK] **Matematikë për biznes**
- [C2969] [3.0 SETK] **Biznesi, Qeveria dhe Shoqëria**
- [C2861] [3.0 SETK] **Komunikimi Afarist**
- [C2640] [6.0 SETK] **Parimet e menaxhmentit**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 2

- [C2120] [6.0 SETK] **Parimet e kontabilitetit**
- [C2641] [6.0 SETK] **Parimet e marketingut**
- [CBE-203] [6.0 SETK] **Mikroekonomia**
- [CBE-302] [6.0 SETK] **Kalkulus biznesi**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 3

- [EBE-410] [6.0 SETK] **E drejta tregtare**
- [C2864] [6.0 SETK] **Statistika për Biznes**

- [CBE-303] [6.0 SETK] **Makroekonomia**
- [CBE-402] [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [3.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**

Semestri 4

- [C2124] [6.0 SETK] **Sistemet informative të biznesit**
- [CBEM-603] [3.0 SETK] **Sjellja organizative**
- [CBM-502] [6.0 SETK] **Financat e korporatës**
- [CBE-401] [6.0 SETK] **Menaxhimi i operacioneve**
- [C2130] [3.0 SETK] **Biznesi ndërkombëtar**
- [3.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 5

- [C2142] [6.0 SETK] **Ndërmarrësia**
- [C2126] [3.0 SETK] **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**
- [EBE-04] [3.0 SETK] **Ekonomia për menaxher**
- [C2125] [6.0 SETK] **Marketingu strategjik**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e biznesit**

Semestri 6

- [CBEM-503] [6.0 SETK] **Hulumtimet e tregut**
- [C2870] [6.0 SETK] **Inovacioni në Qëndrueshmëri dhe Raportimi ESG**
- [C2128] [6.0 SETK] **Strategjia dhe organizata**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e biznesit**

Semestri 7

- [C2145] [6.0 SETK] **Sjellja konsumatore**
- [E2583] [6.0 SETK] **Menaxhimi i inovacionit**
- [C2134] [6.0 SETK] **Analitikë biznesi dhe modelim**
- [E2591] [6.0 SETK] **Biznesi digjital**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e avancuar**

Semestri 8

- [C2874] [6.0 SETK] **Marketingu digjital**
- [C2873] [6.0 SETK] **Zhvillimi i produkteve dhe menaxhimi i markës**
- [CBEE-603] [6.0 SETK] **Ekonometria**
- [C2867] [6.0 SETK] **Punim diplome**
- [6.0 SETK] **Lëndë zgjedhore e avancuar**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Bazat e ekonomisë dhe biznesit**
  Objektivat: Të kuptohen konceptet themelore të ekonomisë dhe biznesit. Të zhvillohet aftësia për të analizuar marrëdhëniet midis faktorëve ekonomikë dhe vendimeve të biznesit. Të aftësohen studentët për të përdorur terminologjinë bazë ekonomike dhe të biznesit. Të nxisin mendimin kritik dhe aftësinë për të lidhur teorinë me praktikat reale të tregut. Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje: Të shpjegojë konceptet themelore të ekonomisë dhe biznesit. Të identifikojë faktorët që ndikojnë në funksionimin e tregjeve dhe ndërmarrjeve. Të aplikojë njohuritë bazë për analizimin e situatave të thjeshta ekonomike dhe të biznesit. Të

komunikojë në mënyrë efektive idetë ekonomike dhe të biznesit.

- **Matematikë për biznes**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i njohë studentët me parimet themelore të komunikimit në biznes dhe të zhvillojnë aftësinë e tyre për të komunikuar në mënyrë efektive në mjedise profesionale dhe organizative. Kursi përqendrohet në përmirësimin e aftësive të komunikimit verbal, joverbal, të shkruar dhe dixhital që janë thelbësore për bashkëpunimin, negocimin dhe ndërveprimin profesional në organizatat moderne të biznesit. Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të: 1. Kuptojnë parimet dhe rëndësinë e komunikimit të biznesit në organizata. 2. Zbatojnë teknikat e komunikimit verbal dhe joverbal në kontekste profesionale. 3. Përgatitin dokumente të qarta dhe efektive të shkruara biznesi, siç janë email-et, portet dhe memorandumet. 4. Demonstrojnë aftësi efektive komunikimi në takime, prezantime dhe negociata. 5. Përdorin mjetet e komunikimit dixhital në mënyrë të përshtatshme në mjedise profesionale. 6. Komunikojnë ide qartë dhe profesionalisht në mjedise multikulturore dhe organizative.

- **Biznesi, Qeveria dhe Shoqëria**
  Lënda ka për qëllim krijimin, zhvillimin dhe avancimin e dijeve të studentëve në fushën e marrëdhënieve ndërmjet biznesit, institucioneve qeveritare dhe shoqërisë. Përmes kësaj lënde, studentët do të pajisen me njohuri bazike dhe praktike lidhur me: □ rëndësinë e kursit BQSH për menaxherët dhe profesionistët e së ardhmes; □ korporatat dhe stejkholderët e tyre; □ menaxhimin e çështjeve publike dhe marrëdhëniet me palët e interesit; □ funksionimin e biznesit në një botë të globalizuar; □ etikën dhe përgjegjësinë organizative; □ marrëdhënien biznes–qeveri; □ rolin e teknologjisë dhe ndikimin e saj në marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike; □ sfidat bashkëkohore në raportin midis zhvillimit ekonomik, qeverisjes dhe interesit publik.

- **Komunikimi Afarist**
  Objektivat e lëndës: - Studentët do të inkurajohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, në zgjidhjen detyrave dhe problemeve të ndryshme nga lënda e matematikës. - Studentët të njihen me konceptet bazë nga algjebra lineare si dhe të aplikojnë njohuritë e tyre permes modeleve lineare në fushën e energjenetikë, ekonomisë dhe mjedisit jetësor. - Studentët të kuptojnë mirë progresionin aritmetik dhe gjeometrik si dhe ta zbatojnë në zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga fusha e energjenetikës, ekonomisë dhe mjedisit jetësor. - Studentët të posedojnë njohuri të mjaftueshme nga fusha e matematikës financiare si dhe aplikimin e tyre fushën e energjisë, ekonomisë dhe mjedisit jetësor.

- **Parimet e menaxhmentit**
  Lënda ka për synim njohtimin e studentëve me esencën e menaxhmentit dhe krijimin e një baze e cila do të plotësohet nga lëndët tjera menaxheriale dhe organizative që studentët do ti dëgjojnë gjatë studimit të tyre. Kjo lëndë ka disa qëllime kryesore, edhe atë: Studentët ti kuptojnë dhe sqarojnë konceptet dhe teoritë kryesore të menaxhmentit. - Të inicohet mendimi kritik në klasë. - Të aftësohen studentët që informatat e fituara ti shfrytëzojnë për të dhënë vlerësime dhe për të konstruktuar argumente. - Të zhvillohen aftësitë komunikuese të studentëve. - Të informohen studentët me procesin e menaxhmetit dhe detyrat e menaxherit. - Të informohen studentët me procesin e planifikimit. - Të informohen studentët me proceset dhe modelet e vendim marjes. - Të njohtohen studentët me organizimin, përfshirë këtu edhe ndarjen e punës dhe gjerësinë dhe thellësinë e menaxhmentit. - Studentët të jenë në gjendje që në praktikë të zbatojnë njohuri mbi relacionet individ-organizatë dhe elementet e ndryshme që kanë të bëjnë me sjelljen organizative, duke përfshirë këtu personalitetin,sjelljet dhe percepcionet. - Studentët të fitojnë njohuri mbi motivimin dhe teoritë e motivimit.

- **Parimet e kontabilitetit**
  Qëllimi i lëndës është që të ndihmojë studentët të kuptojnë thelbin e kontabilitetit; të mësojnë konceptet dhe parimet bazë të kontabilitetit. Në këtë drejtim, lënda synon që studentët të marrin dije dhe kuptim për pasqyrat financiare, zërat bilancor të tyre, rregullat bazë të regjistrimit të dhënave kontabël, parimet përgjithësisht të pranuara të kontabilitetit, etj.

- **Parimet e marketingut**
  Овој предмет им нуди на студентите еден преглед на маркетинг функциите , со акцент создавање на вредност преку маркетинг, истражување на пазарот, однесувањето на потрошувачите , стратегии на цените, маркетинг канали и дистрибуција, и методи на промоција. Студентите ќе можат: □ ја разберерат улогата на маркетинг во рамките на општеството и во рамките на економскиот систем. □ - да ја научат виталната улога на маркетинг во рамките на една фирма и потребните односи помеѓу маркетинг и други функционални области на бизнисот. □ да сметаат на различни области на одлуки во рамките на маркетинг и на алатки и методи кои се користат од страна на маркетинг менаџерите за донесување на одлуки . □ да научат клучните маркетинг принципи и

терминологија и концепти. ? да ценат како маркетиншкиот аспект е важен во нивниот личен и професионален развој.

- **Mikroekonomia**
  Lënda ka për qëllim që të njoftojë studentët me principet dhe konceptet e Mikroekonomisë, e cila do t'ju mundësojë dhe aftësojë studentët e Biznesit dhe të Ekonomisë me mjete dhe teknika analitike të domosdoshme që të analizojnë dhe të japin zgjedhje çështjeve relevante dhe aktuale në sferën e Mikroekonomisë. Kjo lëndë do t'i aftësojë studentët me njohuri teorike dhe praktike si vijon: 1. Analiza e kërkesës dhe ofertës dhe ekulibri i tregut; 2. Elasticiteti dhe aplikimi i tij, 3. Analiza e kostove dhe aplikimi i tyre; 4. Analiza e maksimalizimit të profitit në të gjitha llojet e konkurencës; 5. Konkurenca e plotë dhe jo e plotë; dhe 6. Qeveria dhe mikroekonomia.

- **Kalkulus biznesi**
  Lënda është hartuar për t'u ofruar studentëve një kuptim të koncepteve themelore dhe zbatimeve të tyre praktike në fushën e biznesit, ekonomisë dhe financës. Studentët duhet të jenë në gjendje të aplikojnë teknikat e kalkulusit për të zgjidhur probleme të botës reale që përfshijnë optimizimin, analizën marxhinale dhe modelimin ekonomik. Rezultatet e të nxënit: - Studentët do të kuptojnë konceptet kryesore të kalkulusit duke përfshirë limitet, derivatet dhe integralet si dhe teknikat e vazhdimësisë, diferencueshmërisë dhe optimizimit. - Do të jenë në gjendje të zbatojnë teknikat matematikore në modelet ekonomike për të analizuar funksionet e kostos, modelet e të ardhurave dhe maksimizimin e fitimit. Të kuptojnë marrëdhëniet midis kostos marxhinale, të ardhurave marxhinale dhe fitimit marxhinal. - Të zgjidhin problemet e optimizimit si dhe interpretimin e rezultateve matematikore në kontekstin e vendimeve biznesore dhe ekonomike.

- **E drejta tregtare**
  Studentët duhet të zotërojnë njohuri dhe aftësi për të: • Kuptuar dhe interpretuar konceptet themelore të së drejtës tregtare, duke përfshirë kontratat dhe marrëdhëniet juridike ndërmjet subjekteve tregtare; • Aplikuar njohuritë e të drejtës civile dhe të personave juridikë në kontekstin tregtar; • Analizuar dhe vlerësuar marrëdhëniet dhe detyrimet juridike në aktivitetin tregtar dhe biznesin e përditshëm; • Zgjidhur probleme konkrete juridike që lidhen me aktivitetin tregtar dhe sundimin e ligjit në këtë fushë.

- **Statistika për Biznes**
  Objektivat e lëndës : • Të kuptojnë dhe të aplikojnë metodat statistikore në analizën e treguesve ekonomikë, konsumit të energjisë dhe parametrave mjedisorë. • Të përdorin statistikat për parashikime dhe vendimmarrje në sektorë të ndryshëm. • Të zotërojnë përdorimin e softuerëve statistikorë si SPSS, R, Python dhe Excel. Rezultatet e të nxënit: • Nxënësi do të jetë në gjendje të analizojë tregues ekonomikë (PBB, papunësia, inflacioni) dhe të interpretojë të dhëna për energjinë dhe mjedisin. • Nxënësi do të përdorë metoda statistikore për parashikimin e konsumit të energjisë dhe ndikimit mjedisor. • Nxënësi do të prodhojë raporte të strukturuara dhe interpretime të bazuara në të dhëna statistikore.

- **Makroekonomia**
  Studentët do të fitojnë njohuri për: - konceptet dhe kategoritë makroekonomike, të cilat janë një parakusht për funksionimin e një ekonomie kombëtare që është pjesë e një sistemi më të gjerë ekonomik global; - rëndësinë e treguesve kryesorë makroekonomik siç janë: prodhimi kombëtar bruto, të ardhurat kombëtare, rritja ekonomike, cikli ekonomik, investimet dhe konsumi publik, inflacioni, papunësia, paratë dhe bankat, buxheti, bilanci i pagesave, etj; - instrumentet bazë të analizës makroekonomike (oferta dhe kërkesa agregate) dhe politikat makroekonomike (politika monetare dhe fiskale), etj; - funksionimin efikas të një ekonomie kombëtare, duke e krahasuar atë me ekonomitë moderne të tregut, duke shënuar në atë drejtim ndryshime, ngjashmëri dhe mundësi për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë përkatëse; - njohuri në fushën e makroekonomisë, e cila do të mundësojë qasje më të lehtë për lëndët e tjera të përparuara makroekonomike.

- **Kontabiliteti financiar**
  Qëllimi i kësaj lënde është të ofrojë njohuri dhe aftësi mbi procesin e regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të transaksioneve afariste të shoqërive tregtare, në përputhje me Ligjin për kontabilitet në RMV dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK). Një theks i veçantë i kushtohet hartimit dhe interpretimit të pasqyrave financiare, përfshirë: Bilancin e Gjendjes dhe të Suksesit, Bilancin tatimor –Tatimi në fitim dhe në të ardhura të përgjithshme si dhe raporteve të tjera konform ligjit për udhëheqje kontabël në RMV.

- **Sistemet informative të biznesit**
  Objektivat: • Të kuptojnë konceptet themelore të sistemeve informative të biznesit. • Të shpjegojnë rolin e IS në

strategji, menaxhim dhe vendimmarrje. • Të analizojnë çështje të etikës, privatësisë dhe sigurisë. • Të zhvillojnë aftësi praktike për përdorimin e sistemeve digjitale në biznes. Rezultatet e të nxënit: Studentët do të jenë në gjendje të: • Definojnë IS dhe të shpjegojnë funksionet e tyre kryesore. • Identifikojnë mundësitë e avantazhit konkurrues me IS. • Zbatojnë njohuritë për bazat e të dhënave, rrjetet dhe aplikacionet e biznesit. • Vlerësojnë ndikimin e IS në shoqëri, organizata dhe individë.

- **Sjellja organizative**
  Qëllimi i lëndës kursi është t'u ofrojë studentëve njohuri themelore mbi sjelljen organizative, duke u përqendruar në mënyrën se si sillen individët dhe grupet brenda organizatave. Kursi shqyrton koncepte kyçe si motivimi, lidershipi, komunikimi, dinamika e grupit dhe kultura organizative, duke i mundësuar studentëve të kuptojnë dhe analizojnë sjelljen në mjediset organizative. Rezultatet e të nxënit: • shpjegojnë konceptet dhe teoritë themelore të sjelljes organizative • analizojnë sjelljen individuale në organizata, duke përfshirë personalitetin, perceptimin dhe motivimin • kuptojnë dinamikën e grupit dhe punën në grup në mjediset organizative • vlerësojnë stilet e lidershipit dhe ndikimin e tyre në performancën organizative • analizojnë proceset e komunikimit brenda organizatave • kuptojnë ndikimin e kulturës organizative dhe strukturës organizative në sjelljen e punonjësve • zbatojnë konceptet e sjelljes organizative në situata reale organizative

- **Financat e korporatës**
  Objektivat e kësaj lënde konsistojnë në pajisjen e studentëve me njohuri bazike dhe në zgjerimin e kompetencave ekzistuese drejt kuptimit të aspekteve bashkëkohore teorike dhe praktike të menaxhimit financiar dhe financave të korporatës. Theksi vendoset në analizën e gjendjes dhe performancës së bizneseve/korporatave afariste përmes pasqyrave financiare dhe burimeve të tjera relevante, si dhe në aplikimin e teknikave moderne të vendimmarrjes investive.

- **Menaxhimi i operacioneve**
  Studentët njihen me çështjet komplekse të menaxhimit të prodhimit të kuptuara si një proces i planifikimit dhe organizimit të prodhimit, por edhe si kontroll i funksionimit të prodhimit si një sistem, për të arritur qëllimet e prodhimit me mënyra më efektive dhe më efikase. Brenda kësaj kornize, vëmendje e veçantë u kushtohet aspekteve të mëposhtme të menaxhimit të prodhimit: prodhimi si sistem, planifikimi i sistemit të prodhimit, produkti- dizajnimi i produktit, produkti- cilësia e produktit, programi i prodhimit të produktit, vendndodhja e prodhimit, kapaciteti i prodhimit, pajisjet e prodhimit, ndërtesat e fabrikës, planifikimi i hapësirës së fabrikës, proceset e prodhimit, planifikimi dhe monitorimi i prodhimit në kohë, kontrolli i inventarit, sistemi i magazinimit dhe transportit të brendshëm, mirëmbajtja e pajisjeve dhe ndërtesave dhe sigurimi i prodhimit të energjisë, kontrolli i kostos dhe struktura organizative e prodhimit.

- **Biznesi ndërkombëtar**
  Lënda synon t'u ofrojë studentëve një kuptim të thellë të mjedisit global të biznesit dhe forcave komplekse që nxisin globalizimin, përfshirë ndryshimet teknologjike, liberalizimin e tregtisë dhe zhvillimin e preferencave të konsumatorëve. Vëmendje e veçantë i kushtohet eksplorimit të strategjive të ndryshme që firmat përdorin kur hyjnë në tregjet ndërkombëtare, si eksporti, ndërmarrjet e përbashkëta, françiza dhe investimet e huaja direkte, duke theksuar përparësitë dhe kufizimet e secilës qasje. Për më tepër, studentët do të analizojnë në mënyrë kritike rreziqet dhe mundësitë politike, ekonomike dhe kulturore që ndikojnë në aktivitetet e biznesit ndërkombëtar, duke i aftësuar ata të njohin si sfidat ashtu edhe përfitimet e operacioneve ndërkufitare. Kursi gjithashtu synon të pajisë studentët me aftësitë thelbësore për të marrë vendime të informuara në lidhje me tregtinë ndërkombëtare, investimet dhe financat, duke ndërthurur njohuritë teorike me studime praktike të rasteve. Së fundi, theksi vendoset mbi kuptimin e ndikimit më të gjerë të biznesit ndërkombëtar në ekonomitë dhe kulturat lokale, duke i inkurajuar studentët të vlerësojnë se si praktikat e biznesit global ndikojnë në zhvillimin, punësimin, qëndrueshmërinë dhe shkëmbimin kulturor në rajone të ndryshme të botës.

- **Ndërmarrësia**
  Objektivat e lëndës: ? Të kuptojnë konceptet dhe parimet e ndërmarrësisë. ? Të zhvillojnë aftësi për identifikimin e mundësive dhe rreziqeve të biznesit. ? Të aplikojnë metoda të menaxhimit dhe inovacionit në sipërmarrje. ? Të forcojnë kreativitetin dhe aftësitë analitike në zgjidhjen e problemeve. Rezultatet e të nxënit: ? Studentët do të jenë në gjendje të hartojnë një ide biznesi dhe plan veprimi. ? Studentët do të identifikojnë mundësi tregu dhe të analizojnë riskun. ? Studentët do të përdorin mjete të menaxhimit për projektet e tyre sipërmarrëse. ? Studentët do të demonstrojnë kreativitet dhe zgjidhje inovative të problemeve.

- **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**
  Objektivat: Të kuptojë konceptet themelore të zinxhirit të furnizimit. Të zhvillojë aftësi për planifikimin, organizimin

dhe menaxhimin e proceseve logjistike. Të aftësojë studentët në përdorimin e strategjive dhe mjeteve për optimizimin e furnizimit dhe shpërndarjes. Rezultatet e të nxënit: Shpjegon konceptet dhe modelet e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit. Analizon rolin e logjistikës në performancën organizative. Aplikon metoda për menaxhimin e burimeve, stoqeve dhe transportit. Propozon strategji për përmirësimin e efikasitetit të zinxhirit të furnizimit.

- **Ekonomia për menaxher**
  Qëllimi i lëndës është t'u japë studentëve aftësinë për të zbatuar konceptet ekonomike në vendimmarrjen menaxheriale. Studentët do të fitojnë kompetenca në analizën e kërkesës dhe ofertës, strukturave të tregut, çmimit optimal, kostove dhe strategjive konkurruese. Në fund të kursit, ata do të jenë në gjendje të përdorin modelet ekonomike për të zgjidhur probleme reale të biznesit dhe të marrin vendime efikase.

- **Marketingu strategjik**
  Kjo lëndë synon të trajtojë temat në strategjinë e marketingut. Strategjia e marketingut merret me mënyrën se si menaxhohen klientët për të maksimizuar fitimet e kompanisë. Theksi i lëndës do të jetë në menaxhimin strategjik të procesit të targetimit, përfitimit, mbajtjes dhe zhvillimit të klientëve. Lënda do të shqyrtojë menaxhimin si të strategjisë ashtu edhe të organizimit për të ndërtuar klientë me vlerë për rritjen dhe fitimet e kompanisë. Në çdo modul do të diskutohet një studim rasti mbi një problem të një firme, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zbatojnë konceptet e mësuara, si dhe strategjitë përkatëse në situatat e dhëna.

- **Hulumtimet e tregut**
  Qëllimi i lëndës Hulumtimet e tregut është të kuptohet roli i hulumtimit të tregut në marrjen e vendimeve, të bëhet dallimi midis metodave sasiore dhe cilësore të kërkimit, të dizajnohen dhe realizohen pyetësorë dhe intervista, të analizohen dhe interpretohen të dhënat duke përdorur metoda statistikore, si dhe të prezantohen rezultatet e hulumtimit në formë të një raporti profesional.

- **Inovacioni në Qëndrueshmëri dhe Raportimi ESG**
  Lënda synon të pajisë studentët me aftësinë për të integruar parimet e qëndrueshmërisë në strategjitë e biznesit dhe proceset e inovacionit. Studentët do të zhvillojnë kompetenca kritike në lundrimin e rregulloreve globale të ESG-së, menaxhimin e të dhënave etike dhe vlerësimin e rreziqeve klimatike. Kursi nxit mendimin strategjik për të kaluar nga modelet tradicionale të biznesit drejt ekonomisë qarkulluese, duke përgatitur udhëheqës që mund të balancojnë përfitimin financiar me ndikimin social dhe mjedisor. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: Të analizojnë ndikimin e faktorëve ESG në vlerësimin e kompanisë dhe koston e kapitalit. Të zbatojnë metodologjinë e "Materialitetit të Dyfishtë" për të identifikuar rreziqet dhe mundësitë kryesore të biznesit. Të hartojnë raporte të qëndrueshmërisë duke përdorur standardet ndërkombëtare si GRI, SASB dhe TCFD. Të llogarisin emetimet e karbonit dhe të propozojnë strategji për dekarbonizim. Të vlerësojnë etikën e inovacioneve të reja për të parandaluar "Greenwashing" (marketingun e rremë të gjelbër).

- **Strategjia dhe organizata**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri mbi konceptet dhe proceset e menaxhimit strategjik dhe organizimit të ndërmarrjeve. Lënda fokusohet në analizën e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatave, formulimin dhe implementimin e strategjive konkurruese, si dhe rolin e strukturës organizative në realizimin e strategjisë. Rezultatet e të nxënit: • kuptojnë konceptet kryesore të menaxhimit strategjik • analizojnë mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm të organizatave • identifikojnë dhe vlerësojnë strategjitë konkurruese të ndërmarrjeve • kuptojnë lidhjen ndërmjet strategjisë dhe strukturës organizative • zhvillojnë aftësi analitike për marrjen e vendimeve strategjike

- **Sjellja konsumatore**
  Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve njohuri mbi mënyrën se si individët dhe grupet zgjedhin, blejnë, përdorin dhe hedhin poshtë mallrat dhe shërbimet. Lënda fokusohet në faktorët psikologjikë, socialë dhe kulturorë që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes së konsumatorëve. Studentët mësojnë koncepte kyçe si motivimi, perceptimi, qëndrimet, të mësuarit dhe personaliteti, si dhe ndikimin e kulturës, grupeve referuese dhe klasës shoqërore në sjelljen e konsumatorit. Po ashtu, trajtohet mënyra se si zhvillohen strategjitë e marketingut bazuar në njohuritë për konsumatorët. Në fund të lëndës, studentët janë të aftë të analizojnë sjelljen e konsumatorit dhe ta aplikojnë këtë njohuri në hartimin e strategjive më efektive të marketingut.

- **Menaxhimi i inovacionit**
  Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi lidhur me proceset e gjenerimit, zhvillimit dhe implementimit të ideve inovative në organizata. Lënda fokusohet në kuptimin se si inovacioni nxit rritjen e biznesit,

konkurrueshmërinë dhe krijimin e vlerës në tregje dinamike dhe të ndryshueshme. Studentët mësojnë koncepte kyçe si strategjitë e inovacionit, menaxhimi i ideve, zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve, kreativiteti organizativ dhe menaxhimi i proceseve të inovacionit. Po ashtu, trajtohet roli i teknologjisë, sipërmarrjes dhe trendeve të tregut në formësimin e aktiviteteve inovative. Në fund të lëndës, studentët janë të aftë të planifikojnë, menaxhojnë dhe vlerësojnë proceset e inovacionit që mbështesin suksesin organizativ.

- **Analitikë biznesi dhe modelim**
  Lënda përqendrohet në procesin e transformimit të të dhënave në informacione për zgjidhjen e problemeve të biznesit në botën reale. Lënda ka një qasje fazore në gjenerimin e njohurive: së pari, mësohet analitika përshkruese ku përdoret analitika vizuale për të karakterizuar të dhënat; së dyti, mësohet analitika rekomanduese që përqëndrohet në strategjitë optimale që "duhet" të ndërmerren në të ardhmen; së treti, mësohet analitika parashikuese që përqëndrohet në përdorimin e algoritmeve për parashikimin e të ardhmes në bazë të dhënave historike. Temat përfshijnë: eksplorimin e të dhënave, përgatitjen e të dhënave, optimizimin jolinear, etj.

- **Biznesi digjital**
  Objektivat e programit të lëndës: - Kuptimi i përkufizimit bazë dhe hierarkisë së njohurive për biznesin dixhital dhe kuptimi i proceseve që lidhen me funksionimin, teknikat e marketingut dhe çështjet teknologjike të sistemeve dixhitale; - Analizimi i të dhënave për aktivitetin e përdoruesve në mënyrë që të merren vendime të informuara në lidhje me marketingun dhe menaxhimin e biznesit në organizatë dhe zhvillimin e produktit / shërbimit; - Zbatimi i teknikave themelore të pozicionimit në internet (SEO) në krijimin e imazhit të marketingut të organizatës, si dhe markës së produktit (brendim); - Njohja dhe kuptimi i rëndësisë së internetit si mjedis për krijimin e proceseve shoqërore dhe të biznesit; - Demonstrimi i tendencës për përdorimin aktiv të internetit në aktivitetet ekonomike dhe sociale dhe krijimin e karrierës tuaj.

- **Marketingu digjital**
  Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve njohuri mbi përparësitë biznesore të marketingut digjital dhe rëndësinë e tij për suksesin e marketingut të një organizate. Marketingu digjital është fusha ku marketingu takohet me internetin dhe format e tjera të mediave të reja. Ai përfshin reklamimin online dhe pjesëmarrjen në rrjetet sociale, përdorimin e mediave digjitale dhe krijimin e përmbajtjes së marketingut; optimizimin e faqeve të internetit dhe SEO optimizimin; si dhe njohuri bazike për Google Analytics për matjen e efektit të marketingut digjital dhe kuptimin e trendeve të ardhshme. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara do t'u ndihmojnë studentëve të hartojnë dhe vlerësojnë një plan të marketingut digjital, me qëllim menaxhimin efikas të performancës së marketingut digjital.

- **Zhvillimi i produkteve dhe menaxhimi i markës**
  Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi për procesin e krijimit, zhvillimit dhe menaxhimit të produkteve dhe brendeve në një mjedis biznesi konkurrues. Lënda fokusohet në kuptimin e mënyrës se si produktet inovative dizajnohen, testohen dhe lansohen në treg, si dhe si ndërtohen dhe menaxhohen identitetet e forta të brendit. Studentët mësojnë konceptet kryesore si menaxhimi i ciklit jetësor të produktit, pozicionimi i brendit, vlera e brendit dhe perceptimi i konsumatorit. Po ashtu, trajtohen strategjitë për lansim të suksesshëm të produkteve, diferencim dhe zhvillim afatgjatë të brendit. Në fund të lëndës, studentët janë të aftë të zhvillojnë dhe zbatojnë strategji për produkte dhe brende që rrisin konkurrueshmërinë e organizatave në treg.

- **Ekonometria**
  Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi për të zbatuar metoda statistikore dhe matematikore në analizën e të dhënave ekonomike. Lënda zhvillon kompetenca për të ndërtuar dhe interpretuar modele ekonometrike, për të testuar hipoteza dhe për të bërë parashikime. Rezultatet e të nxënit: Studentët do të kuptojnë bazat teorike të ekonometrisë dhe lidhjen e saj me ekonominë. Do të jenë në gjendje të ndërtojnë dhe të interpretojnë modele të regresionit linear. Do të fitojnë aftësi praktike për të përdorur programe statistikore në analizën ekonometrike. Do të jenë të aftë të aplikojnë metoda ekonometrike për analiza dhe vendimmarrje në ekonomi dhe financa.

- **Punim diplome**
  Punimi i diplomës paraqet një formë të pavarur të hulumtimit akademik dhe aplikativ, përmes së cilës studenti demonstron njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve. Punimi fokusohet në analizimin e çështjeve bashkëkohore nga fusha e marketingut dhe menaxhmentit të inovacionit, duke përdorur metoda adekuate kërkimore dhe burime relevante shkencore. Përmes punimit të diplomës, studentët zhvillojnë aftësi analitike, kritike dhe profesionale në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve reale në mjedisin biznesor dhe ekonomik. Gjithashtu, puna kontribuon në përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe për vazhdimin e studimeve në ciklet më të larta akademike.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**
  Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**
  Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**
  Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave studentëve u mundësohet ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**
  Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**
  Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do te përmirësojne shkathtësite për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshem për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 2**
  Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të perfshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**
  Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjediseve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmbushjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturor.

- **Anglishtja e biznesit 1**
  Studentët, do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Anglishtja e biznesit 2**
  Studentët, do të njoftohen me elemente gjuhësore të nevojshme për t'i kuptuar dhe përpunuar parimet dhe konceptet e përdorura gjatë komunikimit në ambient biznesor/afarist. Me përfundimin e suksesshëm të kësaj lënde, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit dhe të të folurit në publik, do të jenë në gjendje të përdorin argumente për mbështetjen e qëndrimeve, por edhe t'i respektojnë mendimet e të tjerëve, si dhe do t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të komunikimit afarist bashkë me aftësitë për gjetje të punës në të ardhmen.

- **Gjuhë angleze 1**
  Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëtve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financat, për diploma universitare, për shkathtësi të punës, për avansimin e tyre personal, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe apo ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimittë kursit, prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje ti kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vetorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumësit, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 2**
  Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëtve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financa, për diploma universitare, për shkathtësi pune, për avansimet e tyre personale, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe ose ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të kursit prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje ti kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vetorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumësit, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 3**
  Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real: të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve për fenomene të ndryshme duke përfshirë krimin dhe katastrofat natyrore, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë, të vlerësojnë përparimin e tyre personal, të marrin pjesë në role dhe dialogje për tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ese për temat në lidhje me temat e materialit të lëndës. Në fund të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B1 të kornizës së përbashkët Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave. Studentët duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe gjendjen martesore dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin në lidhje me gradat universitare dhe arsimin universitar, artin,

udhëtimin dhe sportin.

- **Gjuhë angleze 4**
  Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbushjen e nevojave të një tipi real; të pyesin dhe të japin përgjigje për identifikim personal dhe marrëdhënie personale; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre të përditshme, kohën e lirë, argëtimin, mjedisin e financave, problemet; të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat. Pas përfundimit të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B2 të kornizës së përbashkët Evropiane; Ata pritet të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të munden të zbatojnë disa nga funksionet gjuhësore të mëposhtme: të japin këshilla; të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë.

- **Gjuhë angleze 5**
  Gjuha angleze për qëllime akademike është lëndë me kohëzgjatje prej një semestri. Qëllimet e lëndës janë t'u mundësojë studentëve të fitojnë aftësi të cilat do u ndihmojnë mësimnxënien e tyre gjuhësore dhe përparimin e tyre gjuhësor në një mjedis akademik të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Kursi duhet ti aftësojë të përdorin këta aftësi edhe në orë të gjuhës së huaj si edhe në përparimin akademik në fushat e përmbajtjes. Kursi përfshin aftësi gjuhësore, studiuese dhe në përgjithësi aftësi zbatuese (dëgjim, dhënie të prezantimeve me gojë, argumente konstruktive) në detyra të veçanta. Për këtë arsye, pas përfundimit të suksesshëm të kursit, niveli i zotësisë së gjuhës duhet të jetë në nivelin C1 sipas kornizës së përbashkët Evropiane. Si rezultat, studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë të suksesshme prezantime orale, të marrin pjesë në tribuna të debateve/diskutimeve online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe tu japin të tjerëve informacion kthyes në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe lexojnë thelbin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke shprehur mendimet e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese që zgjidh problemin. Ata duhet të jenë në gjendje të prezantojnë informacion pamor në formën e prezantimit poster në Power Point. Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe faktet mbështetëse në një tekst dhe të analizojnë dhe identifikojnë fjalinë kryesore të temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe të zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**
  Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Kompetencat Digjitale**
  Qëllimi i kësaj lënde është të zhvillojë kompetencat digjitale të studentëve në përputhje me kornizat bashkëkohore të aftësive digjitale. Lënda synon të pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për përdorimin efektiv, kritik dhe të sigurt të teknologjive digjitale në studime dhe në jetën profesionale. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë konceptet themelore të kompetencave digjitale. • Përdorin mjete digjitale për kërkim, komunikim dhe bashkëpunim online. • Menaxhojnë dhe organizojnë informacionin digjital. • Krijojnë përmbajtje digjitale duke përdorur aplikacione të ndryshme. • Zbatojnë praktika të sigurta dhe etike në mjediset digjitale. • Përdorin teknologjitë digjitale për zgjidhjen e problemeve dhe për mësim gjatë gjithë jetës.

- **Dizajnimi i mediumeve digjitale**
  Qëllimi i kësaj lënde është të prezantojë konceptet dhe parimet themelore të dizajnimit të mediumeve digjitale, duke zhvilluar aftësitë kreative dhe teknike të studentëve për krijimin dhe menaxhimin e përmbajtjes digjitale. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë parimet themelore të dizajnit digjital dhe komunikimit vizual. • Analizojnë elementet e dizajnit si ngjyra, tipografia dhe kompozimi. • Përdorin mjete dhe aplikacione digjitale për krijimin e përmbajtjes multimediale. • Zhvillojnë projekte kreative në dizajnin e mediumeve digjitale. • Aplikojnë parimet e përdorshmërisë dhe estetikës në dizajn. • Prezantojnë dhe vlerësojnë projekte të

dizajnit digjital.

- **Hyrje në sigurinë kibernetike**
  Qëllimi i kësaj lënde është të prezantojë konceptet themelore të sigurisë kibernetike dhe të zhvillojë tek studentët ndërgjegjësim për kërcënimet dhe rreziqet në mjediset digjitale. Lënda synon të pajisë studentët me njohuri bazë për mbrojtjen e sistemeve informatike, rrjeteve dhe të dhënave. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • Shpjegojnë konceptet bazë të sigurisë kibernetike dhe rëndësinë e saj në shoqërinë digjitale. • Identifikojnë kërcënimet dhe sulmet më të zakonshme në hapësirën kibernetike. • Kuptojnë parimet bazë të mbrojtjes së sistemeve informatike dhe rrjeteve. • Analizojnë rreziqet e sigurisë dhe praktikat për mbrojtjen e të dhënave. • Zbatojnë praktika të sigurta gjatë përdorimit të teknologjive digjitale. • Zhvillojnë vetëdije për aspektet etike dhe ligjore të sigurisë kibernetike.

- **Inteligjenca artificiale: Veglat dhe zbatimet**
  Qëllimi i kësaj lënde është të prezantojë konceptet bazë të inteligjencës artificiale dhe përdorimin praktik të veglave të AI për krijimin e përmbajtjes digjitale dhe për rritjen e produktivitetit në studime dhe punë. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë konceptet bazë të inteligjencës artificiale dhe AI gjenerative. • Përdorin vegla të ndryshme të AI për krijimin e tekstit, imazheve dhe prezantimeve. • Zbatojnë vegla të AI për organizimin e informacionit dhe mbështetjen e procesit të të mësuarit. • Analizojnë përfitimet dhe kufizimet e përdorimit të inteligjencës artificiale. • Zbatojnë praktika etike dhe të përgjegjshme në përdorimin e AI. • Zhvillojnë projekte praktike duke përdorur aplikacione të inteligjencës artificiale.

- **Modelimi me tabela elektronike**
  Qëllimi i kësaj lënde është të prezantojë konceptet dhe teknikat e modelimit dhe analizës së të dhënave duke përdorur programe për tabela elektronike si Microsoft Excel dhe aplikacione të tjera të ngjashme për spreadsheet. Lënda synon të zhvillojë aftësitë praktike të studentëve për organizimin, përpunimin, analizën dhe vizualizimin e të dhënave në mënyrë efikase. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë strukturën dhe funksionimin e programeve për tabela elektronike. • Organizojnë dhe menaxhojnë të dhëna në spreadsheet. • Përdorin formula dhe funksione për llogaritje dhe analiza të të dhënave. • Aplikojnë teknika të analizës së të dhënave për zgjidhjen e problemeve praktike. • Krijojnë grafikë dhe vizualizime për interpretimin dhe prezantimin e të dhënave. • Zhvillojnë modele të thjeshta analitike duke përdorur spreadsheet software.

- **Lidershipi Publik dhe Zhvillimi Organizativ**
  This course aims to provide students with an understanding of how leaders and managers develop and implement the mission and vision of organizations within the public sector. It explores how essential organizational values for long-term success are developed and applied through appropriate practices, activities, and professional behaviors. The course also focuses on the role of leaders in ensuring the development and implementation of effective management systems, as well as how organizations achieve their mission and vision through clear strategies based on stakeholders' perspectives and supported by relevant policies, plans, objectives, and processes.

- **Etika në institucionet publike**
  Objektivi kryesor i lëndës është t'u ofrojë studentëve një kuadër teorik dhe praktik për të kuptuar dilemat morale në sektorin publik. Lënda synon të kultivojë aftësitë e arsyetimit etik, të promovojë integritetin në vendimmarrjen administrative dhe të përgatisë nëpunësit e ardhshëm publikë për të mbrojtur parimet e transparencës dhe mirëbesimit publik. Lënda shqyrton themelet morale të shërbimit publik dhe sfidat sistemike ndaj qeverisjes etike. Studentët do të hulumtojnë tensionin midis lojalitetit politik (klientelizmit) dhe detyrës profesionale meritokracisë). Fokus i veçantë i kushtohet kontekstit të Maqedonisë së Veriut, duke analizuar pse korrupsioni i profilit të lartë vazhdon të jetë i pranishëm dhe se si "kultura e pandëshkueshmërisë" minon sundimin e ligjit. Në përfundim të lëndësi, studentët do të jenë në gjendje të: • Vlerësojnë politikat publike duke përdorur teoritë kryesore etike (utilitarizmin, deontologjinë dhe etikën e virtytit). • Identifikojnë dhe menaxhojnë konfliktet e mundshme të interesit dhe rreziqet e korrupsionit brenda një organizate. • Zbatojnë standardet ligjore dhe etike në diskrecionin dhe vendimmarrjen administrative. • Hartojnë strategji organizative për të promovuar transparencën dhe për të mbrojtur sinjalizuesit (whistleblowers). • Analizojnë implikimet etike të teknologjive në zhvillim (AI dhe Big Data) në qeverisje.

- **Etika Profesionale e TI**
  Lënda siguron qasje gjithpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtruara në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë

etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi I përgjegjshëm i TI-së.

- **Teknologjitë e Internetit**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'ju ofrojë një kuptim të plotë të mjeteve dhe metodologjive të zgjidhjes së problemeve që lidhen me programimin në anën e klientit (client-side) në internet. Fokusi kryesor do të jetë tek mjetet dhe aftësitë që përdoren nga zhvilluesit e uebit në industrinë e sotme. Ligjëratat do të trajtojnë konceptet e përgjithshme dhe sintaksën, ndërsa ushtrimet laboratorike do të përqendrohen në implementim dhe praktikë. Vëmendja kryesore do të jetë tek teknologjitë në anën e klientit, si: konceptet bazë mbi origjinën e Internetit dhe rrjetëzimin, gjuhët e shënjimit të uebit si HTML5, krijimi i stileve të faqeve të uebit me Cascading Style Sheets (CSS), si dhe përdorimi i JavaScript për të krijuar faqe interaktive të uebit së bashku me bibliotekat përkatëse si jQuery, jQuery Mobile, AppML, AngularJS dhe API-të e HTML5.

- **Kontrolli i infeksioneve spitalore**
  Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri teorike dhe praktike mbi kontrollin dhe parandalimin e infeksioneve spitalore. Studentët do të zhvillojnë kompetenca për identifikimin e faktorëve të rrezikut, zbatimin e masave parandaluese dhe menaxhimin e situatave infektive në institucionet shëndetësore. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: • Kuptojnë konceptet bazë të infeksioneve spitalore dhe mënyrat e përhapjes së tyre • Zbatojnë standardet dhe protokollet për kontrollin e infeksioneve • Identifikojnë dhe vlerësojnë rreziqet në mjediset spitalore • Përdorin teknika adekuate të higjienës dhe dezinfektimit • Bashkëpunojnë në mënyrë efektive në ekip për menaxhimin e infeksioneve

- **Bazat e Dizajn Studios**
  Qëllimi i lëndës Bazat e Dizajn Studios është zhvillimi i aftësive themelore konceptuale dhe praktike në formësimin e hapësirës arkitektonike. Përmes punës individuale dhe në grup, studentët fitojnë kompetenca në analizë, komunikim vizual dhe mendim kritik në kuadër të procesit të projektimit arkitektonik. Pas përfundimit të lëndës, studentët pritet të jenë në gjendje: ● të kuptojnë dhe zbatojnë parimet bazë të projektimit arkitektonik; ● të përkthejnë kërkesat programuese në zgjidhje funksionale hapësinore; ● të realizojnë vizatime dhe modele fizike korrekte; ● të përdorin metoda analoge dhe digjitale për përfaqësimin e ideve; ● të argumentojnë zgjedhjet projektuese përmes prezantimit vizual dhe verbal.

- **E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut**
  Qëllimi i veçantë i programit të lëndës është që studentët të fitojnë njohuri të thella për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e vendosur për mbrojtjen e tyre në nivel, shteteror, rajonal dhe universal. Studentët do të njihen me njohuritë teorike moderne në këtë fushë, si dhe aktet dhe zakonet përkatëse ndërkombëtare dhe do të trajnohen në punë kërkimore në fushën e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

- **Teknologjitë e reja riprodhuese dhe e drejta**
  Qëllimi i lëndës është që studentët të fitojnë njohuri të thelluara dhe kompetenca mbi aspektet juridike, bioetike, mjekësore dhe shoqërore të teknologjive bashkëkohore riprodhuese, si dhe ndikimin e tyre në konceptet e familjes, prindërimit dhe të drejtave të njeriut. Objektivat specifike të lëndës janë: fitimi i njohurive mbi paraqitjen, zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive të reja riprodhuese dhe ndikimin e tyre në shoqërinë moderne; kuptimi i koncepteve themelore juridike që lidhen me riprodhimin, prindërimin dhe gjininë familjare; analiza e kornizës juridike kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e riprodhimit të asistuar biomjekësor; zhvillimi i aftësive për të identifikuar dhe zgjidhur çështje komplekse juridike që lidhen me: statusin juridik të fëmijëve të lindur përmes këtyre teknologjive, të drejtat dhe detyrimet e prindërve dhe donatorëve, konfliktin ndërmjet të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e tij dhe të drejtës për anonimitet të donatorit; kuptimi i dilemave bioetike që lidhen me krijimin e jetës, kërkimet shkencore dhe kufijtë e ndërhyrjes mjekësore; zhvillimi i të menduarit kritik mbi raportin ndërmjet lirisë riprodhuese dhe mbrojtjes së interesit publik dhe interesit më të mirë të fëmijës; nxitja e një qasjeje ndërdisiplinare në analizën e çështjeve juridike që lidhen me bioteknologjinë dhe mjekësinë riprodhuese; zhvillimi i aftësive për analizë kritike të legjislacionit dhe praktikës gjyqësore.

- **Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat e Reja**
  Objektivat e lëndës: □ Të kuptojnë konceptet themelore të marrëdhënieve me publikun (PR) dhe rolin e tyre në komunikimin organizativ. □ Të njohin karakteristikat dhe funksionimin e mediave të reja dhe platformat digjitale në fushën e PR-së. □ Të zhvillojnë aftësi praktike në përdorimin e mjeteve digjitale për komunikim efektiv me publikun. □ Të analizojnë dhe vlerësojnë strategjitë e komunikimit në kontekste reale. □ Të integrojnë njohuritë teorike me praktikën profesionale në planifikimin e fushatave PR. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: □ Përshkruajnë dhe shpjegojnë rolin e PR-së dhe ndikimin e mediave të reja në komunikimin modern. □ Analizojnë rastet studimore dhe të identifikojnë strategjitë efektive të komunikimit. □ Hartojnë plane të thjeshta komunikimi duke përdorur mjete digjitale dhe media sociale. □ Vlerësojnë efektivitetin e fushatave PR dhe ndikimin e tyre tek publikun.

 Zbatojnë parimet etike dhe profesionale në komunikimin me publikun dhe median.

- **Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi**
  Lënda synon zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe komunikative të studentëve, duke përfshirë përdorimin korrekt të gjuhës standarde, përvetësimin e rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore, si dhe aftësinë për të analizuar dhe interpretuar tekste të ndryshme. Po ashtu, studentët do të mësojnë parimet dhe teknikat e hartimit të punimeve shkencore, përfshirë strukturimin e tyre, citimin dhe përdorimin e burimeve akademike. Pas përfundimit të lëndës, studenti pritet të jetë në gjendje të hartojë tekste të qarta, të strukturuara dhe koherente, të përdorë në mënyrë të saktë normat gjuhësore dhe të demonstrojë aftësi kritike në lexim dhe shkrim.

- **Financat personale**
  Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi praktike për menaxhimin efektiv të financave personale gjatë gjithë jetës. Lënda fokusohet në zhvillimin e kompetencave për planifikimin financiar personal, menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, përdorimin e produkteve financiare, si dhe për marrjen e vendimeve të informuara lidhur me kursimin, investimin dhe menaxhimin e borxhit. Përmes analizës së situatave reale dhe përdorimit të mjeteve financiare praktike, studentët do të zhvillojnë aftësi për të planifikuar dhe menaxhuar burimet financiare në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë konceptet dhe parimet themelore të menaxhimit të financave personale; • përgatisin buxhete personale dhe plane financiare afatshkurtra dhe afatgjata; • analizojnë opsionet e kursimit dhe investimit për arritjen e qëllimeve financiare; • menaxhojnë kreditë, borxhin dhe përdorimin e produkteve bankare dhe financiare; • vlerësojnë rreziqet financiare dhe rolin e sigurimeve në menaxhimin e tyre; • planifikojnë qëllime financiare afatgjata si investimet dhe pensionimi; • marrin vendime financiare të informuara dhe të përgjegjshme në jetën personale dhe profesionale.

- **Menaxhimi i Projekteve**
  Kjo lëndë synon t'i njohë studentët me botën e projekteve moderne dhe t'i përgatisë për përballjen me mundësitë dhe sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin dhe menaxhimin e projekteve që i përgjigjen nevojave konkrete. Ajo fokusohet në kuptimin e fazave të zhvillimit të një projekti, si dhe në rolin thelbësor të menaxherit të projektit në përcaktimin e nevojave, fushës së veprimit, aktiviteteve të zbatimit dhe kompleksitetit të dizajnit modern të projekteve. Gjithashtu, lënda synon të aftësojë studentët për përdorimin e mjeteve dhe teknikave bashkëkohore të menaxhimit të projekteve, duke e shndërruar një ide ose nevojë në një projekt real, të strukturuar dhe të dokumentuar. Në këtë mënyrë, studentët zhvillojnë kreativitetin, inovacionin dhe rrisin konkurrueshmërinë e tyre në tregun e punës.

- **Plani i biznesit**
  Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike mbi hartimin dhe zhvillimin e një plani biznesi. Ajo fokusohet në analizën e idesë së biznesit, vlerësimin e tregut, planifikimin financiar dhe operacional, si dhe në strategjitë për zbatimin dhe zhvillimin e një biznesi të qëndrueshëm.

- **Ekonomiksi i mendimit praktik**
  Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve një kuptim praktik të parimeve bazë të ekonomisë, duke i ndihmuar ata të aplikojnë të menduarit ekonomik në vendimmarrjen e përditshme, si në nivel personal ashtu edhe profesional. Lënda thekson rëndësinë e përgjegjësisë individuale, proceseve të tregut, politikave të shëndosha ekonomike dhe rolit të institucioneve në përmirësimin e mirëqenies ekonomike.

- **Arsimim Online dhe Digjital**
  Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shekullit 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatet në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t`i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t`i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Letërsi Angleze dhe Filmi**
  Qëllimet e lëndës janë si vijon: - të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit - diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike - analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese - diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët - paraqitja e perspektivave të

ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore.

- **Etika e biznesit dhe përgjegjësia korporative**
  Objektivat: 1. Prezantimi i teorive dhe kornizave kryesore etike të aplikueshme në vendimet e biznesit. 2. Shpjegimi i evolucionit historik dhe zgjerimit bashkëkohor të përgjegjësisë sociale të korporatave (CSR). 3. Zhvillimi i aftësive për identifikimin e çështjeve etike në kontekste të ndryshme biznesi. 4. Analizimi i interesave të palëve të interesuara dhe implikimeve etike të zgjedhjeve menaxheriale. 5. Vlerësimi i strukturave të qeverisjes korporative dhe rolit të tyre në mbikëqyrjen etike. 6. Eksplorimi i mekanizmave ligjorë, rregullatorë dhe vullnetarë që formësojnë sjelljen e përgjegjshme të biznesit. 7. Shqyrtimi i qëndrueshmërisë, etikës mjedisore dhe përgjigjeve të biznesit ndaj ndryshimeve klimatike. 8. Nxitja e arsyetimit etik, argumentimit dhe aftësive vendimmarrëse. 9. Rritja e vetëdijes mbi dimensionet ndërkulturore dhe globale të etikës së biznesit. 10. Përgatitja e studentëve për të hartuar dhe vlerësuar strategji CSR dhe politika etike për organizatat.

- **Këshillim Biznesi dhe Zgjidhje Problemesh**
  Objektivat: • Të kuptohet roli dhe procesi i konsulencës në biznes. • Të zhvillohen aftësi për analizë dhe identifikim të problemeve organizative. • Të aplikohen metoda dhe modele për zgjidhje efektive të problemeve. • Të zhvillohen aftësi për punë ekipore dhe prezantim profesional të zgjidhjeve. Pas përfundimit të lëndës studenti do të jetë në gjendje të: • Analizojë probleme komplekse në organizata. • Përdorë metoda të strukturuara të problem solving. • Zhvillojë rekomandime strategjike për biznese. • Prezantojë dhe argumentojë zgjidhje profesionale.

- **Tregu i punës**
  Qëllimi kryesor i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuritë bazë dhe njohuritë e thelluara në fushën e teorisë së tregut të punës, pastaj me mekanizmin e funksionimit të tij në ekonominë e tregut. Lënda Tregu i Punës, ka si mision t'u ofrojë dhe t'u mësojë studentëve kategoritë, ligjet dhe parimet kryesore me të cilat funksionon tregu i punës. Lënda u bën një analizë të hollësishme mënyrës së sjelljes dhe rolit që luajnë agjentët kryesorë të tregut të punës: individëve, firmave dhe qeverisë. Analiza mbështetet në dy kategoritë themelore: të kërkesës për punë dhe të ofertës së punës, të cilat gjejnë aplikim pothuajse në të gjitha temat që trajtohen në këtë lëndë. Njohuritë e përfituara nga studentët në këtë lëndë shërbejnë si bazë teorike themelore e domosdoshme për të kuptuar e përvetësuar teoritë dhe politikat e ndryshme që aplikohen në tregun e punës. Lënda synon që studentët të kuptojnë se si tregjet e punës shpërndajnë dhe përdorin në mënyrë efikase faktorin e rrallë të prodhimit, punën. Leksionet përfshijnë njohuri të koncepteve të kërkesës për punë e të ofertës së punës dhe aplikimit të tyre praktik; sjelljen e individëve në tregun e punës për të maksimizuar dobishmërinë e tyre; sjelljen e firmave në tregun e punës që synojnë maksimizimin e fitimit; rolin e qeverisë në tregun e punës, strukturat e ndryshme të tregjeve të punës: tregu i punës në konkurrencë të plotë, monopoli në tregun e punës, monopsoni në tregun e punës, roli i sindikatave në tregun e punës, monopoli bilateral në tregun e punës. Leksionet dhe diskutimet në klasë mbulojnë materiale, të cilët mund të mos jenë në libër dhe disa aspekte të materialeve, që përfshihen në librin bazë nuk do të diskutohen në klasë, por i lihen studimit aktiv të studentit. Prandaj, studenti për të garantuar suksesin në përvetësimin sa më të mirë të lëndës, duhet të jetë i pranishëm në leksione dhe seminare, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutimin e problemeve të ndryshme, që lidhen me tregun e punës.

- **Ekonomia e mjedisit jetësor**
  Ekonomia e mjedisit jetësor synon që studentët të fitojnë njohuri për: - burimet kryesore dhe llojet e agjentëve mjedisorë; - hapat në procesin rregullator në drejtim të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut, si dhe njohuri për të identifikuar legjislacionin aktual dhe rregulloret në lidhje me çështjet mjedisore; - plotësimin e boshllëqeve në lidhje me efektet shëndetësore të agjentëve mjedisorë dhe idenitifkimin e fushave të pasigurisë në procesin e vlerësimit të rrezikut, si dhe - identifikimin dhe përcaktimin e hapave në procesin e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut.

- **Zhvillimi ekonomik lokal**
  Përmes lëndës synohet që studentët të arrijnë: - të kuptojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse kompleksitetin e zhvillimit ekonomik lokal, si dhe aspektet që përbëjnë portofolin e zhvillimit ekonomik lokal; - të vlerësojë në mënyrë kritike avantazhet dhe disavantazhet që dalin nga mënyrat alternative të realizimit të zhvillimit ekonomik lokal; - të vlerësojnë rëndësinë e rrjeteve të krijuara ndërmjet palëve të interesuara në sektorin publik, sektorin e biznesit dhe qeverinë lokale, respektivisht komunat; - të zgjedhin instrumente shkencore për vlerësimin e strategjive të pranueshme për zhvillimin ekonomik lokal,etj.

- **E-tregtia**
  Objektivat e lëndës: Të prezantojë studentët me bazat e tregtisë elektronike si ndërthurje e biznesit, teknologjisë dhe shoqërisë. Të ofrojë njohuri mbi modelet e biznesit digjital, infrastrukturën e tregtisë elektronike dhe platformat online. Të analizojë implikimet ekonomike, sociale dhe rregullatore të tregtisë elektronike. Të zhvillojë aftësi për vlerësimin e

strategjive, teknologjive dhe trendeve të tregut të tregtisë elektronike. Të inkurajojë të menduarit kritik mbi çështjet e besimit, sigurisë, privatësisë dhe etikës në ekonominë digjitale. T'u ofrojë studentëve mjete praktike për hartimin dhe zbatimin e zgjidhjeve në fushën e tregtisë elektronike. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: ? Përkufizojnë dhe shpjegojnë konceptet dhe teoritë kryesore të tregtisë elektronike. ? Identifikojnë dhe vlerësojnë modele të ndryshme të biznesit të tregtisë elektronike dhe strategji të gjenerimit të të ardhurave. ? Analizojnë rolin e infrastrukturës së internetit, web-it dhe teknologjisë mobile në zhvillimin e tregtisë elektronike. ? Vlerësojnë strategjitë e marketingut, reklamimit dhe sjelljen e konsumatorit në tregtinë elektronike. ? Aplikojnë njohuritë mbi sistemet e pagesave, sigurinë dhe kornizat rregullatore në praktikë. ? Kryejnë analiza të studimeve të rasteve nga kompani reale të tregtisë elektronike. ? Hartojnë dhe prezantojnë një projekt ose plan biznesi në fushën e tregtisë elektronike. ? Punojnë në mënyrë bashkëpunuese për të propozuar zgjidhje ndaj sfidave të transformimit digjital.

- **Analiza e të dhënave me Python/R**
  Objektivat e lëndës: • Të kuptojnë metodologjitë themelore të analizës së të dhënave. • Të përdorin mjete dhe biblioteka për analizën e të dhënave në Python/R. • Të zbatojnë praktikisht njohuritë nga statistika dhe analiza e të dhënave. • Të interpretojnë dhe prezantojnë rezultatet analitike përmes teknikave të raportimit dhe analizës së të dhënave. Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të: 1. Përdorin Python/R për përgatitjen dhe analizën e të dhënave. 2. Aplikojnë teknika bazë statistikore dhe analitike mbi të dhëna reale. 3. Pastrojnë, transformojnë dhe organizojnë të dhënat për analiza të mëtejshme. 4. Interpretojnë rezultatet e analizës së të dhënave në kontekst biznesor. 5. Përgatisin raporte analitike duke përdorur mjete të përshtatshme. 6. Zbatojnë analizën e të dhënave si bazë për lëndë më të avancuara në program.

- **Modelimi financiar**
  Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me aftësi praktike në ndërtimin dhe analizimin e modeleve financiare për vendimmarrje ekonomike. Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të ndërtojnë modele financiare të thjeshta dhe komplekse, të analizojnë të dhënat financiare, të parashikojnë performancën financiare dhe të ofrojnë rekomandime të bazuara në analizë numerike.

- **Financat e Ndërmarrësisë**
  Qëllimi i lëndës është të fokusohet në sfidat financiare me të cilat përballen startup-et dhe ndërmarrjet me rritje të shpejtë. Lënda shqyrton burimet e financimit ndërmarrës, duke përfshirë kapitalin sipërmarrës, investitorët engjëj, crowdfunding dhe kapitalin privat. Pas përfundimit me sukses të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: - Kuptojnë ciklin jetësor financiar të ndërmarrjeve sipërmarrëse. - Analizojnë pasqyrat financiare të startup-eve dhe nevojat për financim. - Aplikojnë mjete të analitikës së të dhënave për të vlerësuar performancën dhe rrezikun e startup-eve. - Ndërtojnë projeksione financiare dhe modele vlerësimi për startup-et. - Kuptojnë strukturat e kapitalit sipërmarrës dhe vendimet e investimit. - Përdorin inteligjencën artificiale dhe analizën parashikuese për të vlerësuar potencialin e rritjes së startup-eve. - Hartojnë strategji financimi për biznese inovative.

- **Negocimi dhe Menaxhimi i Konflikteve**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi procesin e negociatave dhe menaxhimin e konflikteve në organizata dhe në mjedisin e biznesit. Lënda fokusohet në zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike për planifikimin, zhvillimin dhe menaxhimin e negociatave efektive, si dhe për zgjidhjen konstruktive të konflikteve. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë konceptet dhe proceset kryesore të negociatave • analizojnë situata të ndryshme negocimi në kontekste biznesi • përdorin strategji dhe taktika efektive të negociimit • identifikojnë dhe menaxhojnë konfliktet në organizata • zhvillojnë aftësi komunikimi dhe vendimmarrjeje në situata negociuese

- **Menaxhimi i shitjes dhe marrëdhëniet me klientët**
  Qëllimi i kësaj lënde është: • Të kuptojë rolin dhe rëndësinë e menaxhimit të shitjeve brenda strukturës organizative të një kompanie, • Të analizojë strategjitë e shitjeve dhe mundësitë e tregut, duke marrë parasysh karakteristikat e produktit, nevojat e klientëve • Të vlerësojë mundësitë e shitjeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat strategjike të organizatës. • Të zhvillojë aftësi profesionale shitjeje dhe praktika efektive të menaxhimit të marrëdhënieve me klientët që rrisin vlerën afatgjatë të klientit. • Të përdorë mjetet dhe teknologjitë e Menaxhimit të Marrëdhënieve me Klientët (CRM) për të përmirësuar proceset e shitjeve, komunikimin me klientët dhe menaxhimin e marrëdhënieve pas shitjes.

- **Menaxhimi i burimeve njerëzore**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri mbi konceptet dhe praktikat kryesore të menaxhimit të burimeve njerëzore në organizata. Lënda analizon proceset e rekrutimit, seleksionimit, motivimit dhe zhvillimit të punonjësve, si dhe rolin e menaxhimit të burimeve njerëzore në përmirësimin e performancës organizative. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë konceptet dhe funksionet kryesore të menaxhimit

të burimeve njerëzore • analizojnë proceset e rekrutimit dhe seleksionimit të punonjësve • kuptojnë rëndësinë e motivimit dhe zhvillimit të punonjësve • analizojnë proceset e menaxhimit të performancës në organizata • zhvillojnë aftësi për menaxhimin e marrëdhënieve ndërpersonale në vendin e punës

- **Ekonomia e sjelljes**
  Qëllimi i lëndës është studimi i faktorëve social, njohës dhe emocionalë të vendimeve ekonomike individuale dhe institucionale, si dhe pasojat e ndryshimeve në çmimin e tregut, fitimet dhe alokimin e burimeve. Modeli i sjelljes është i integruar nga teoria ekonomike dhe përfshin një sërë konceptesh, metodash dhe fushash kërkimore.

- **FinTech dhe Financat Digjitale**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe praktike mbi zhvillimin e teknologjive financiare, transformimin digjital të shërbimeve financiare, modelet e reja të pagesave, bankingun digjital, kreditimin digjital, blockchain, kriptoasetet, financat e decentralizuara dhe sfidat rregullatore, të sigurisë dhe mbrojtjes së konsumatorit në ekosistemin modern financiar. Pas përfundimit të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • shpjegojë konceptet themelore të FinTech dhe të financave digjitale; • analizojë ndikimin e transformimit digjital në banka, institucione financiare dhe tregje financiare; • dallojë modelet kryesore të pagesave digjitale, bankingut digjital, crowdfunding, peer-to-peer lending dhe insurtech; • vlerësojë potencialin dhe kufizimet e blockchain, smart contracts, crypto-assets dhe DeFi; • identifikojë rreziqet që lidhen me cybersecurity, privatësinë, mashtrimet digjitale dhe mbrojtjen e të dhënave; • interpretojë çështjet kryesore rregullatore dhe etike në financat digjitale; • përdorë raste studimore dhe analiza praktike për të vlerësuar zgjidhje FinTech në kontekste reale biznesore dhe financiare.

- **Vizuelizimi i të dhënave**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi praktike për vizualizimin efektiv të të dhënave dhe interpretimin e rezultateve analitike. Studentët do të mësojnë parimet e dizajnit të vizualizimeve, mënyrat e paraqitjes së të dhënave komplekse dhe përdorimin e mjeteve moderne për krijimin e grafikëve dhe dashboard-eve interaktive. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë parimet e vizualizimit të të dhënave • analizojnë dhe interpretojnë të dhëna përmes grafikëve dhe vizualizimeve • përdorin mjete moderne për krijimin e vizualizimeve të të dhënave • dizajnojnë vizualizime efektive për prezantimin e rezultateve analitike • komunikojnë informacion kompleks në mënyrë të qartë dhe vizuale

- **Teoria e lojës dhe strategjia e biznesit**
  Kjo lëndë përqëndrohet në metodat analitike që rrjedhin nga teoria e lojës, e cila siguron një kornizë rigoroze analitike për strukturimin e situatave konkurruese, identifikimin e alternativave dhe zgjedhjen midis tyre. Qasja themelore do të jetë prishja e kompleksitetit të pjesëve, vazhdimi i përdorimit të mjeteve të siguruara nga teoria e lojërave për të analizuar këto pjesë, dhe pastaj mbledhja e pjesëve në një kuptim logjik koherent. Qëllimi është që të bëhen vendimmarrës më të mirë strategjikë kur përballen me sfida konkurruese. Objektivat kryesore do të jenë përdorimi i koncepteve dhe mjeteve të teorisë së lojërave për të identifikuar, diagnostikuar dhe analizuar sfidat konkurruese me të cilat përballen kompanitë në mjedisin dinamik dhe të zbatojnë konceptet dhe mjetet e teorisë së lojërave për të zhvilluar strategji të cilat do t'u japin atyre një avantazh konkurrues.

- **Udhëheqja me proceset e biznesit**
  Për të maksimalizuar krijimin e vlerës, organizatat duhet të analizojnë, dokumentojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht efikasitetin dhe efektivitetin e proceseve të tyre të biznesit. Me një fokus në bazat e menaxhimit të procesit të biznesit, qëllimi i kësaj lënde është të mësojë se si përdoret teknologjia e informacionit për të mundësuar dhe menaxhuar proceset e biznesit. Tri fushat kryesore të lëndës janë shkëmbimi i të dhënave të ndërmarrjes, sistemet e ndërmarrjeve dhe menaxhimi dhe analiza e procesit.

- **Tema në zhvillim në Biznes dhe Inteligjencë Artificiale**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'u ofrojë studentëve njohuri mbi zhvillimet më të fundit në fushën e inteligjencës artificiale dhe ndikimin e saj në biznes. Lënda trajton aplikimet e AI në vendimmarrjen biznesore, marketing, financa, operacione dhe transformimin digjital të organizatave. Pas përfundimit të lëndës studenti do të jetë në gjendje të: • shpjegojë konceptet bazë të inteligjencës artificiale në biznes • analizojë ndikimin e AI në modelet e biznesit dhe strategjitë organizative • identifikojë aplikimet e AI në marketing, financa dhe operacione • vlerësojë rreziqet etike dhe rregullatore të përdorimit të AI • analizojë trendët e reja të teknologjisë AI dhe ndikimin e tyre në ekonomi

- **Analitiza e të dhënave financiare**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi për analizën e të dhënave financiare duke përdorur metoda statistikore, modele ekonometrike dhe teknika moderne të analizës së të dhënave. Lënda fokusohet

në përdorimin e mjeteve të programimit dhe analizës së të dhënave për të analizuar tregjet financiare, për të modeluar rrezikun dhe për të mbështetur vendimmarrjen financiare. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë konceptet kryesore të analizës së të dhënave financiare • përdorin metoda statistikore dhe ekonometrike për analizën e të dhënave financiare • analizojnë seri kohore financiare dhe parashikojnë trendet • përdorin mjete programimi për analizë të të dhënave financiare • interpretojnë rezultatet analitike për vendimmarrje financiare

- **Kontabiliteti i aplikuar**
  Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuri praktike mbi aplikimin e kontabilitetit në organizata dhe ndërmarrje duke përdorur programe kontabël dhe dokumentacion financiar standard. Studentët do të mësojnë proceset kryesore të regjistrimit të transaksioneve financiare dhe përgatitjes së raporteve financiare. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • kuptojnë proceset kryesore të kontabilitetit në organizata • regjistrojnë transaksione financiare në sistemet kontabël • përdorin programe kontabël për përpunimin e të dhënave financiare • përgatisin raporte financiare bazë • interpretojnë informacionin financiar për vendimmarrje

- **Marketingu ndërkombëtar**
  Lënda synon të pajisë studentët me një kuptim gjithëpërfshirës të marketingut në një kontekst global. Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të analizojnë mjedisin global të marketingut, përfshirë faktorët kulturorë, politikë, ekonomikë dhe ligjorë që ndikojnë në biznesin ndërkombëtar. Ata do të zhvillojnë strategji për hyrje dhe konkurrencë në tregjet ndërkombëtare, do të aplikojnë konceptet e marketingut në ndërtimin e markës globale, adaptimin e produkteve, çmimet, shpërndarjen dhe promovimin, si dhe do të vlerësojnë sjelljen e konsumatorëve në vende dhe kultura të ndryshme. Për më tepër, studentët do të mësojnë të përdorin metrika dhe mjete analitike për të vlerësuar efektivitetin e strategjive të marketingut ndërkombëtar dhe të zbatojnë konceptet teorike në sfidat reale të marketingut global përmes studimeve të rasteve.

- **Financat e patundshmërive dhe analiza e investime**
  Qëllimi i lëndës është t'i pajisë studentët me njohuri dhe aftësi analitike për vlerësimin e investimeve në pasuri të paluajtshme si një klasë e rëndësishme e aseteve. Lënda fokusohet në analizën e tregjeve të patundshmërive, vlerësimin e pronës, strukturat financiare dhe vendimmarrjen investuese. Pas përfundimit të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: • analizojnë tregjet e patundshmërive dhe mundësitë e investimit • aplikojnë metoda për vlerësimin e pronës • vlerësojnë strukturat e financimit dhe kreditimit • kryejnë analiza investimi duke përdorur NPV, IRR dhe cash flow • analizojnë rrezikun dhe kthimin në investime • marrin vendime investuese të bazuara në analiza financiare

- **Analiza e të Dhënave Mjedisore dhe Llogaritja e Karbonit**
  Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi analizën e të dhënave mjedisore dhe konceptet kryesore të kontabilitetit të karbonit. Lënda synon të zhvillojë aftësitë e studentëve për të mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhënat mjedisore, si dhe për të vlerësuar emetimet e gazeve serrë në nivel institucional, lokal dhe kombëtar. Përmes përdorimit të metodave statistikore dhe mjeteve analitike, studentët do të kuptojnë rolin e të dhënave në hartimin e politikave mjedisore dhe strategjive për zhvillim të qëndrueshëm.

- **Logjistika dhe Automatizimi**
  Qellimet e lëndës: - Njoftojë studentët me aspektet teknike dhe të automatizimit të sistemeve logjistike. - Forcojë të kuptuarit se si teknologjitë e informacionit dhe automatizimit përmirësojnë logjistikën moderne. - Jep njohuri praktike mbi rolin e dixhitalizimit dhe Industrisë 4.0 në optimizimin e zinxhirëve të vlerës. - Zhvillojë aftësi analitike dhe zgjidhjeje problemesh në automatizimin e logjistikës.

- **Auditimi**
  Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara mbi aspektet konceptuale, teorike dhe praktike të auditimit. Ajo ndërton mbi njohuritë ekzistuese në kontabilitet dhe i përgatit studentët për të kuptuar në mënyrë profesionale rolin dhe funksionin e auditimit në praktikë. Objektivi kryesor i lëndës është të trajtojë çështjet kyçe me të cilat përballet profesioni i auditimit, si në nivel lokal ashtu edhe ndërkombëtar, duke analizuar mjedisin në të cilin operon. Lënda fokusohet në standardet profesionale, parimet etike dhe kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e auditimit. Gjithashtu, studentët do të udhëzohen përmes një qasjeje të strukturuar që ndjek të gjitha fazat e procesit të auditimit, nga pranimi i angazhimit deri te përgatitja dhe prezantimi i raportit përfundimtar, duke zhvilluar aftësi praktike dhe profesionale për ushtrimin e këtij profesioni